



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 12 nëntor 2020, përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, u zhvillua mbledhja e radhës e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Zëvendësimin e licencës për transmetime analoge me licencë shërbimi programi audioviziv të shoqërisë “Media Motiv” sh.a.” për të ofruar shërbim në qarqet Shkodër dhe Lezhë. **(Vendimi nr. 125, datë 12.11.2020)**
2. Pajisjen e subjektit person fizik Fred Stakaj, me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audiovizive mbështetur më internet (OTT) “Tv Lezha” dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së subjektit për transmetim analog. **(Vendimi nr. 126, datë 12.11.2020)**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “ALBTELECOM” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv “INFO CHANNEL”. **(Vendimi nr. 127, datë 12.11.2020)**
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “TIBO” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “TIBO”. **(Vendimi nr. 128, datë 12.11.2020)**
5. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Net 3 Digital” sh.p.k., për rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Net 3 Digital”. **(Vendimi nr. 129, datë 12.11.2020)**
6. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Endri Leka, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor E&G”. **(Vendimi nr. 130, datë 12.11.2020)**
7. Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kristal” te shoqëria “LIBCOM” sh.p.k. **(Vendimi nr. 131 datë 05.11.2020)**

AMA pasi shqyrtoi propozimin e Këshillit të Ankesave ra dakord t’u kërkojë subjekteve audiovizive kombëtare respektimin e detyrimit për “*gjuhën e shenjave*”.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 3 anëtarë të AMA-s e ndërprejnë mbledhjen dhe çështja e mëposhtme:

- Relacion dhe projektvendim “Për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”,

për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhet për në mbledhjen e radhës.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 12 nëntor 2020